



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.919/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, Vlora Maliqi nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Vlora Maliqi kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me shenjen ZL.Anr.919/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Vlora Maliqi kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se rezultati i publikuar i votave është jo real, andaj ka kërkuar që të rinumërohen këto vendvotime: 1902e/01R, 1902e/02R, 1902e/03R, 1902e/04R, 1902e/05R, 1902e/06R, 1902e/07R, 1902e/08R, 1904e/01R, 1904e/02R, 1904e/03R, 1904e/04R, 1904e/05R, 1904e/06R, 1904e/07R, 1904e/08R, 1904e/09R, 1904e/10R, 1904e/11R, 1904e/12R, 1904e/13R, 1905e/01R, 1905e/02R, 1905e/03R, 1905e/04R, 1905e/05D, 1910e/01R, 1910e/02R, 1910e/03R, 1910e/04R, 1910e/05R, 1910e/06D, 1911e/01R, 1911e/02R, 1911e/03R, 1911e/04R, 1911e/05R, 1911e/06R, 1911e/07D, 1915e/01R, 1915e/02R, 1915e/03R, 1915e/04R, 1915e/05R, 1915e/06R, 1915e/07D, 1917e/01R, 1917e/02R, 1917e/03R, 1917e/04R, 1917e/05R, 1917e/06R, 1917e/07D, 1918e/01R, 1918e/02R, 1918e/03R, 1918e/04R, 1918e/05D, 1919e/01R, 1919e/02R, 1919e/03R, 1919e/04R, 1919e/05R, 1919e/06R, 1919e/07D, 1920e/01R, 1920e/02R, 1920e/03R, 1920e/04R, 1920e/05R, 1920e/06D, 1920x/01R, 1920x/02R, 1920x/03R, 1920x/04R, 1920x/05R, 1920x/06D, 1921x/01R, 1921x/02R, 1921x/03R, 1921x/04R,

1921x/05R, 1921x/06D, 1923e/01R, 1923e/02D, 1926e/01R, 1926e/02R, 1926e/03R, 1926e/04D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së apelit, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesja e apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë për të mbështetur pretendimet e saj në apel. Prandaj, apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.919/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesues i Panelit
Zyheri Haziri



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*